



Janar—Prill 2012

PËRMBAJTJA:

Përkushtimi ndaj tatimpaguesve

- Realizimi i seminareve me tatimpagues në të gjitha regjionet e ATK-së
- Linja on-line dhe kutitë e vërejtjeve dhe sugjerimeve


Të hyrat Janar-Prill 2012

- ATK, tejkalon të hyrat



Të tjera:

- Memorandum bashkëpunimi mes ATK-së dhe PTK-së
- Memorandum bashkëpunimi mes ATK-së dhe ARBK-së
- Bashkëpunimi mes ATK-së dhe Trustit

Të hyrat Janar-Prill 2010-2012



LINJA E BASHKËPUNIMIT PA PAGESË

NGA:  dhe 



0800-80-800

BULETINI Janar – Prill 2012

Administrata Tatimore e Kosovës, në kuadër të planit të punës dhe përmbledhjes së aktiviteteve, pasqyron buletin katër-mujor të aktiviteteve, të cilat janë realizuar në periudhën Janar-Prill 2012.

Misioni :

- Të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore,
- Të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve, në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve, si dhe
- Të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëjlojshëm, si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të hyra për buxhetin e Qeverisë së Kosovës në mënyrë efikase dhe me kosto të ultë.

Fjalimi i Drejtorit të Përgjithshëm

Të nderuar tatimpagues,

Administrata Tatimore e Kosovës, si çdo vit edhe në vitin 2012, është e përkushtuar në zhvillimin dhe hartimin e planeve, të cilat do të ndihmojnë në inkasimin e të hyrave.

Ndër synimet e shumta që ka ATK-ja në vizionin e saj, është edhe informimi i saktë dhe me kohë i përcaktimit të objektivave për tatimpagues, me qëllim të ngritjes së përmbushjes vullnetare. Besojmë se tanimë jeni të informuar rreth implementimit të Strategjisë së Përmbushjes 2012-2015, përmes së cilës ne mund të shfrytëzojmë burimet tona në mënyrë më efektive për të siguruar zbatimin e legjislacionit tatimor nga tatimpaguesit.



Sistemi ynë tatimor bazohet në parimet e vetëvlerësimit dhe përmbushjes vullnetare. Përmbushja vullnetare mbështetet nga qytetarët, të cilët vullnetarisht përcaktojnë obligimet e tyre tatimore dhe dorëzojnë deklaratat dhe pagesat.

Dua të ju rikujtoj se viti që e lamë pas, ka qenë vit që kemi korrur suksese të shumta, veçanërisht në lancimin e projekteve siç janë E-Deklarimi-EDI, i cili ka rezultuar mjaft i suksesshëm, si dhe Qendra e Thirrjeve, e cila vazhdimisht është duke e ngritur cilësinë e identifikimit të saktë dhe azhurnimin e regjistrimit të tatimpaguesve, si dhe eliminimin e mundësive të gabimeve në sistemin e të dhënave.

Të gjitha këto që i përmendëm do të ishte e pa mundur të realizohen pa besimin e tatimpaguesve. Ne besojmë se mënyra më efektive për të përfituar dhe mbajtur përmbushjen vullnetare është përmes ndërtimit të raporteve të besimit dhe respektit të ndërsjellë, në mes të Administratës Tatimore dhe tatimpaguesve të Kosovës.

Shpresoj se do t'i bashkoheni ATK-së, për të siguruar se sistemi ynë është i drejtë dhe secili është duke paguar pjesën e vet drejtë, sepse kjo është mënyra e vetme, e cila mundëson që të kontribuojmë në buxhetin e Republikës së Kosovës, nga i cili qytetarëve u mundësohet infrastrukturë e mirë ligjore, arsimore, shëndetësore, rrugore, pensionale etj.

Ju faleminderit që paguani tatimet dhe që kontribuoni në zhvillimin ekonomik të vendit tonë!

Sinqerisht,

Behxhet Haliti

Drejtore i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës

Fillim i mbarë për stabilitetin buxhetor

Edhe këtë fillim vit Administrata Tatimore e Kosovës, ka hedhur hapin e sigurt në rolin e vet në vjeljen e të hyrave për buxhetin e Republikës së Kosovës.


ATK për periudhën Janar-Prill 2012 të këtij viti ka arritur të vjel të hyra në 100,1 milion euro.

Me këtë trend të të hyrave është realizuar 35 % nga totali i planit vjetor, i cili është 287,8 milionë euro, apo më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar, si dhe shuma me e lartë e vjelë gjatë tri viteve të fundit për të njëjtën periudhë.

Sigurisht se sukseset e vazhdueshme bazohen në baza të shëndosha të ndërtuara vit pas viti dhe punë të zellshme të stafit të ATK-së, duke ofruar shërbime sa më të mira dhe duke krijuar barazi për të gjithë tatimpaguesit.

Përkundër vështirësive të shumta, ATK është e vendosur të vazhdojë me përkushtim më të madh që të realizojë suksese të mëtutjeshme në misionin e saj, në ngritjen e përmbushjes vullnetare konform legjislacionit tatimor.

Ky trend është arritur falë punës së palodhshme të stafit të ATK-së, të cilët gjatë gjithë vitit paraprak kanë punuar në ngritjen e kapaciteteve vepruese, zhvillimin e projekteve të reja, grumbullimin dhe përpunimin e informatave, rritjen e kualitetit të shërbimeve ndaj tatimpaguesve, si dhe ofrimin e lehtësirave tjera për kryerjen e obligimeve tatimore në mënyrë vullnetare.



20 Mars 2012

ATK dhe PTK, nënshkruan një Memorandum bashkëpunimi me qëllim të ofrimit të shërbimeve të ndërsjella në fushën e burimeve njerëzore

Në vazhden e bashkëpunimeve me institucionet vendore, Administrata Tatimore e Kosovës, përkatësisht Drejtori i Përgjithshëm z. Behxhet Haliti, gjatë muajit Mars nënshkroi një Memorandum bashkëpunimi me Postë Telekomin e Kosovës, respektivisht me Kryeshefin Ekzekutiv të PTK-së, z. Ejup Qerimi.

Memorandumi i nënshkruar, do të ndihmojë në krijimin e mundësive të bashkëpunimit të ndërsjellët, të fokusuar drejt përmirësimit të perspektivës së institucioneve, me mundësi reale që zotërojnë këto dy institucione, duke plotësuar një nga misionet më të rëndësishme, që ka të bëjë me zhvillimin e burimeve njerëzore.

Fokusi kryesor i këtij memorandumi, është zhvillimi i burimeve njerëzore në lëmin e trajnimeve, ku Administrata Tatimore e Kosovës dhe Qendra e Trajnimit dhe Zhvillimit e PTK-së, do të ofrojnë të gjitha mundësit për realizimin e trajnimeve sipas kërkesave dhe mundësive, përkatësisht brenda kapaciteteve që kanë në dispozicion.

Gjatë nënshkrimit të këtij memorandumi, palët u shprehën se arsyet e këtij bashkëpunimi, vijnë si rrjedhojë e një përkushtimi për zbatim transparent dhe efektiv të shërbimeve, zbatim të barabartë dhe të njëtrajtshëm të ligjit, si dhe një angazhim për kushte më të mira dhe efektive për veprimtarinë e përmbushjes tatimore.

Memorandumi ka hyrë në fuqi që nga momenti i nënshkrimit nga të dy palët, (20 Mars 2012).



Pas nënshkrimit të memorandumit për bashkëpunim, mes ATK-së dhe PTK-së

ATK dhe ARBK, të përkushtuara në krijimin e lehtësirave për të bërit biznes

Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Memorandumi i bashkëpunimit, ka për qëllim lehtësimin e procedurave të regjistrimit të bizneseve në Kosovë.

Ky hap lehtësues për afarizmin është ndërmarrë në kuadër të reformave që aplikohen nga Qeveria e Kosovës për të bërit biznes në Kosovë.

Ky memorandum do të formojë bazën për të rregulluar kushtet sipas të cilave ATK-ja dhe ARBK-ja janë pajtuar për një zgjedhje transitore me integrimin e sistemeve informative aktuale të të dy institucioneve, në kuadër të regjistrimit të bizneseve.

Këto reforma tani mundësojnë që me regjistrimin e biznesit, që do të bëhet në ARBK, afaristët do të pajisjen me certifikatë të regjistrimit të biznesit, ku në të do të jetë edhe numri fiskal, si dhe janë eliminuar procedurat tjera, të cilat deri më tani janë kryer në trekëndëshin ATK – MTI - Dogana e Kosovës.

Një bashkëpunim i tillë reflekton përkushtimin e të dy institucioneve për zhvillimin e veprimtarive biznesore, në mënyra bashkëkohore, të cilat janë në përputhje me praktikat e vendeve të zhvilluara.

Po ashtu, pas nënshkrimit të memorandumit, para të pranishmeve janë prezantuar format e skicuar për procesin e ri të regjistrimit të bizneseve.



Procesi i bashkëpunimit ndërinstitucional



Gjatë nënshkrimit të MiM, ATK-ARBK

Lehtësirat për zhvillimin e biznesit—Deklarimi elektronik— EDI

Nga 1 Maji 2012 punëdhënësit, do të mund të kryejnë procesin e deklarimit të kontributit pensional dhe tatimit në paga në mënyrë elektronike. Përfaqësuesit e bizneseve nuk do të kenë më nevojë të bëjnë raportime tremujore, e as mbushje të disa formularëve për deklarim. Procesi, mund të kryhet duke u regjistruar në ueb-faqen e ATK-së dhe duke ngarkuar çdo muaj një format standard të deklarimit me të dhënat e nevojshme.

Procesi i ri do të marrë shumë më pak kohë dhe bizneset do të zvogëlojnë koston administrative. Në anën tjetër do të jetë edhe në të mirë të kontribuuesve pensionalë, pasi do të kufizohet në minimum mundësia e mungesës së informacionit në emër të kujt paguhen kontributet pensionale, një problem jo pak i vogël në të kaluarën.

Është e pritshme se këto ndryshime do të ndikojnë pozitivisht edhe në raportin mes ATK-së, dhe tatimpaguesve, duke ulur ndjeshëm koston e të bërit biznes në Kosovë, ndërsa Trusti do të ketë informacion më të saktë dhe në kohë për kontribuuesit dhe kursimet e tyre pensionale.


E gjithë kjo do të bëhet e mundur falë sistemit të ri të ndërtuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në bashkëpunim me Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti).

Por projekti për deklarimin elektronik të kontributeve pensionale dhe tatimit në paga duke filluar nga 1 Maji 2012 do të jetë fillimisht mundësi alternative e deklarimit, e nuk do të jetë domosdo forma vetme e deklarimit të bizneseve. Forma aktuale e raportimit, përmes formularëve të posaçëm

dhe raportimit tremujor, do të mund të përdoret deri në fund të muajit Korrik. Kjo periudhë tremujore ,do të jetë parapërgatitore, informuese e vetëdijesuese për punëdhënësit deri në kalimin e plotë dhe të vetëm në sistemin e deklarimit elektronik.



Zyrtarizimi i bashkëpunimit mes ATK-së dhe Trustit



Përkushtimi ndaj tatimpaguesve—Seminare me tatimpagues në të gjitha regjionet e ATK-së

Administrata Tatimore e Kosovës, me qëllim të ngritjes së përmbushjes vullnetare nga ana e tatimpaguesve dhe informimit me të drejtat dhe detyrimet e tyre, në vazhden e aktiviteteve të shumta, ka realizuar seminare me tatimpagues në të gjitha regjionet e ATK-së.

Seminaret janë mbajtur në: Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Prishtinë, në të cilat janë prezantuar tema, si: ***Përgatitja dhe dorëzimi i Deklaratave Vjetor, Raportimi i Blerjeve mbi 500 euro, si dhe Risitë në Legjislacionin Tatimor.***

Pjesëmarrës në këto seminare ishin tatimpagues, organizata biznesi, njësi të përhershme, OJQ, përfaqësues të tyre, si dhe qytetarë të interesuar për temat e lartpërmendura.

Para tatimpagueseve në mënyrë të detajuar janë trajtuar çështjet tatimore si: deklarimi vjetor dhe deklarimi i kësteve paradhënie për Tatimin në të Ardhura Personale dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave, përpilimi i deklarave tatimore dhe deklarimi i të ardhurave nga Ortakëria.

Gjithashtu, me fokus të veçantë janë trajtuar edhe çështje të tjera si: Raportimi i Blerjeve mbi 500 euro, E-deklarimi (deklarimi elektronik), ndryshimi i normave të interesit dhe shpjegimet publike të nxjerra nga ATK, gjatë muajit Mars, si: Shpjegimi Publik Nr. 01/2012, i cili rregullon trajtimin për çështje tatimore nga aspekti i TVSh-së, të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve të realizuara nga Ndërmarrjet Publike dhe Shpjegimi Publik Nr. 02/2012, i cili rregullon trajtimin për çështje tatimore nga aspekti i TVSh-së, të transaksioneve të realizuara nga Kompanitë e Sigurimeve dhe Ri-sigurimeve, si dhe çështje të tjera me interes.

Gjatë këtyre seminareve, pjesëmarrësit kanë parashtruar pyetje të ndryshme, lidhur me temat e prezantuara, si dhe pyetje të tjera lidhur me Legjislacionin tatimor, si dhe zhvillimet në raport me tatimpaguesit. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit, ATK iu ka ofruar përgjigje adekuate.

Pjesëmarrja e tatimpaguesve në këto seminare ka qenë mjaft e lartë, me ç'rast u janë shpërndarë materiale informuese, si: Fletëpalosje për TVSh, Fletëpalosje për TAK, Fletëpalosje për TAP, Fletëpalosje për “Të drejtat dhe obligimet e Tatimpaguesit”, si dhe Fletëpalosje me Informata të përgjithshme për Administratën Tatimore të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës, është e përkushtuar në inkurajimin e përmbushjes së detyrimeve tatimore në baza vullnetare nga të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë për obligim të përgjigjen në detyrimet e tyre tatimore në afatin e paraparë ligjor, në mënyrë që ATK, të mos detyrohet të vendos ndëshkimet për mosrespektimin e afateve të parapara me legjislacionin tatimor të Kosovës.



Seminaret me tatimpagues

Linja on-line dhe kutitë e vërejtjeve dhe sugjerimeve

Në mënyrë që të raportohen rastet e evazionit tatimor, korrupsionit, apo sjelljeve jo të mira nga stafi i ATK-së, Administrata Tatimore e Kosovës, çdoherë shqyrton informacionet të cilat mundësohet të raportohen përmes Linjës së bashkëpunimit pa pagesë në

Nr. Tel: **0800- 80-800**, të cilat njëkohësisht mbesin të mbrojtura në çfarëdo rrethane.

Vetëm për periudhën Janar-Mars 2012, përmes kësaj linje janë raportuar nëntë (9) raste, ku lidhur me rastet në fjalë janë zhvilluar aktivitete edukuese dhe janë lëshuar gjoba për parregullsi tatimore në vlerë prej 1,550 euro, si dhe katër (4) prej këtyre aktiviteteve janë në procedurë të vazhdueshme.

Mundësi tjetër e cila ofron bashkëpunim të afërt me qytetar është edhe kutia e vërejtjeve dhe sugjerimeve.

Në të gjitha zyrat regjionale të ATK-së, janë të vendosura kutitë e vërejtjeve dhe sugjerimeve, të cilat janë mundësi e mirë dhe e lehtë për qytetarët, për ti ofruar ATK-së, informacionet për mos respektimin e lëshimit të kuponëve fiskal, korrupsionin, apo sjelljet jo të mira nga stafi i ATK-së.

Në përdhën Janar-Mars 2012, në kutinë e vërejtjeve janë gjetur 197 informacione, ku në bazë të këtyre informatave të evidentuara janë zhvilluar aktivitetet e nevojshme dhe varësisht parregullsive tatimore janë ndëshkuar 87 tatimpagues, me gjoba në vlerë prej 40,250 euro.

Si çdoherë ATK-ja, është e përqendruar në trajtimin e barabartë të të gjithë tatimpaguesve, dhe vazhdon të jetë afër shqyrtimit dhe edukimit të çfarëdo çështjeje, e cila ndërlidhet me detyrat dhe kompetencat e saj.



Risi të tjera



Identiteti i ri
korporativ
17 Janar 2012



0800-80-800

- Ndryshimi i linjës për lajmërimin e rasteve të evazionit tatimor, korrupsionit apo sjelljeve jo të mira të stafit të ATK-së

Linja telefonike për bashkëpunim

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Klinton & Dëshmorët e Kombit 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 30 & 200 250 07
e-mail: zyra.komunikim@atk-ks.org web: www.atk-ks.org

TELEFONI:

NJTM:	038/200-346-41
Prishtina - 1	038/200-255-21
Prishtina - 2	038/200-255-02
Prishtina - 3	038/200-255-17
Pejë:	039/432-812
Gjilan:	0280/326-967
Prizren:	029/244-963
Ferizaj:	0290/321-668
Mitrovicë:	028/590-667
Gjakovë:	0390/330-021
Zyra Qendrore:	038/200-250-17